



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 3678 Prot.

Tiranë, më 27.04.2026

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1530, datë 24.12.2010.

SHOQËRISË “O MINING” SH.P.K

Njësia Administrative Nr. 9, Rr. “Nikolla Lena”, Ish markata e vjetër, Tiranë

Për dajeni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “O MINING” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1530, datë 24.12.2010, për mineralin Hekur-Nikel, në Objektivin “Guri i Kuq”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 3605 prot., datë 08.10.2025, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 6966 prot., datë 10.10.2025, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1530, datë 24.12.2010, për mineralin Hekur-Nikel, në Objektivin “Guri i Kuq”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë, pasi në objekt nuk zhvillohet aktivitet minierar prej më shumë se një viti kalendarik.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1530, datë 24.12.2010, për mineralin Hekur-Nikel, në Objektivin “Guri i Kuq”, Bashkia Pogradec, që shoqëria Juaj zotëron.**

Referuar pikës 2, neni 48 “Procedura e revokimit të lejes”, keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1530, datë 24.12.2010, për mineralin Hekur-Nikel, në Objektivin “Guri i Kuq”,

Bashkia Pogradec, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48
“Procedura e revokimit të lejes”, të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në
Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

MINISTRI
ENEA KARAKAÇI
ME URDHËR PËR DELEGIM
ZËVENDËSMINISTRI
ERLIND SULO



The image shows a handwritten signature in blue ink, which is highly stylized and loops around a circular official stamp. The stamp is from the Ministry of Infrastructure and Energy of the Republic of Albania, located in Tirana. The text on the stamp includes "REPUBLIKA E SHqipëRIE", "MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË", and "TIRANË".